


AL

# gorenje

**UDHËZIME TË DETAJUARA  
PËR PËRDORIMIN E  
FRIGORIFERIT DHE  
NGRIRËSIT NË FORMË  
DOLLAPI**



Ne ju falënderojmë për besimin që keni treguar duke blerë pajisjen tonë elektroshtëpiake, e cila është projektuar për të lehtësuar jetën tuaj. Për ta bërë më të thjeshtë përdorimin e këtij produkti, ne kemi ofruar udhëzimet e detajuara për përdorim dhe udhëzimet e instalimit të dhëna në një fletë të veçantë. Udhëzimet duhet t'ju mundësojnë që të mësoni për pajisjen tuaj elektroshtëpiake të re sa më shpejt që të jetë e mundur.

Ne dëshirojmë që ju të gjeni mjaft kënaqësi gjatë përdorimit të saj.

### **Pajisja elektroshtëpiake është synuar vetëm për përdorim familjar.**

**Frigoriferi** është synuar për të mbajtur ushqim të freskët në temperaturat mbi 0°C.

**Ngrirësi** është synuar për të ngrirë ushqimin e freskët dhe për të mbajtur për kohë të gjatë ushqimin e ngrirë (deri në një vit, në varësi të llojit të ushqimit).

Ju lutemi të vizitoni faqen tonë të internetit, në të cilën ju mund të fusni numrin e modelit të pajisjes suaj elektroshtëpiake, të treguar në pllakën e të dhënave në fletën e garancisë, për të gjetur përshkrimin e detajuar të pajisjes suaj elektroshtëpiake, këshillat e përdorimit, zgjidhjen e problemeve, informacion për shërbimin, udhëzimet e përdorimit, etj.



<http://www.gorenje.com>



Këshilla të rëndësishme për sigurinë



Informacion dhe këshilla të përgjithshme



Mbrojtja e mjedisit



Mos e lani në lavastovilje

# PËRMBAJTJA

<b>4 SHËNIME DHE REKOMANDIME TË RËNDËSISHME</b> 4 PËRPARA PËRDORIMIT TË PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE PËR HERË TË PARË 5 KËSHILLA TË RËNDËSISHME PËR SIGURINË 7 INFORMACION I RËNDËSISHËM PËR PËRDORIMIN E PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE 8 MBROJTJA E MJEDISIT	HYRJE
<b>9 KËSHILLA PËR KURSIMITIN E ENERGJISË ME PAJISJET ELEKTROSHTËPIAKE FTOHËSE</b>	
<b>10 INSTALIMI DHE LIDHJA</b>	PËRSHKRIMI I PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE
<b>12 PËRSHKRIMI I PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE</b>	
<b>13 KOMANDIMI I APARATIT</b>	
<b>14 NDRYSHIMI I DREJTIMIT TË HAPJES SË DERËS</b>	
<b>16 PAJISJET E BRENDSHME TË PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE</b>	
<b>17 SHPËRNDARJA E REKOMANDUAR E USHQIMIT NË PAJISJEN ELEKTROSHTËPIAKE</b>	
<b>18 MBAJTJA E USHQIMIT NË FRIGORIFER</b>	MBAJTJA DHE NGRIRJA E USHQIMEVE
<b>22 NGRIRJA DHE MBAJTJA E USHQIMEVE TË NGRIRJA</b> 22 Këshilla të rëndësishme për ngrirjen 22 Mbjajtja e ushqimeve të ngrira në mënyrë industriale 23 Koha e mbajtjes së ushqimeve të ngrira 23 Shkrirja e ushqimeve të ngrira	
<b>24 SHKRIRJA E PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE</b>	SHKRIRJA DHE PASTRIMI I PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE
<b>25 PASTRIMI I PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE</b>	
<b>26 ZGJIDHJA E PROBLEMEVE</b>	TË NDRYSHME
<b>28 INFORMACION NË LIDHJE ME ZHURMËN E PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE</b>	

# SHËNIME DHE REKOMANDIME TË RËNDËSISHME

---

## PËRPARA PËRDORIMIT TË PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE PËR HERË TË PARË

Përpara se të lidhni pajisjen elektroshtëpiake me rrjetin elektrik, ju lutemi të lexoni me kujdes udhëzimet e përdorimit të cilat përshkruajnë pajisjen elektroshtëpiake dhe përdorimin e saj të rregullt dhe të duhur. Udhëzimet zbatohen për disa lloje/modele të pajisjeve elektroshtëpiake; prandaj, këtu mund të përshkruhen parametra ose pajisje të cilat nuk janë të disponueshme në pajisjen tuaj elektroshtëpiake. Ne ju rekomandojmë që ta ruani këtë manual udhëzimi për referenca në të ardhmen dhe ta vendosni bashkë me pajisjen elektroshtëpiake në qoftë se do ta shisni në të ardhmen.

Kontrolloni për të gjitha dëmtimet ose parregullsitë në pajisjen tuaj elektroshtëpiake. Në qoftë se konstatooni se pajisja juaj elektroshtëpiake është e dëmtuar, njoftojeni shitësin nga i cili e keni blerë pajisjen elektroshtëpiake.

Përpara se të lidhni pajisjen elektroshtëpiake me rrjetin elektrik, lereni pajisjen elektroshtëpiake të qëndrojë në pozicion vertikal për një minimum prej 2 orësh. Kjo do të zvogëlojë mundësinë e defekteve të operimit për shkak të efekteve të transportit në sistemin e ftohjes.






## KËSHILLA TË RËNDËSISHME PËR SIGURINË

Pajisja elektroshtëpiake duhet të lidhet me rrjetin elektrik dhe të tokëzohet në përputhje me standardet dhe rregullat në fuqi.

Përpara se të pastroni pajisjen elektroshtëpiake, shkëputeni nga rrjeti elektrik (hiqeni kabllin e energjisë nga priza e murit).

Në qoftë se dëmtohet kablli i energjisë, duhet të zëvendësohet nga teknik shërbimi ose nga një person tjetër i trajnuar në mënyrë të përshtatshme.

Në qoftë se nuk punon drita LED, thërrisni një teknik shërbimi. Mos u përpiqni të riparoni vetë ndriçimin LED, pasi ka rrezik të kontaktit me tensionin e lartë!

-  **KUJDES!** Mos përdorni asnjë pajisje elektrike brenda pajisjes elektroshtëpiake, me përjashtim të atyre që lejohen nga prodhuesi i kësaj pajisjeje frigoriferike.
-  **KUJDES!** Mos përdorni asnjë pajisje mekanike ose mjete të tjera për të përshpejtuar procesin e shkrirjes, të ndryshme nga ato të rekomanduara nga prodhuesi.
-  **KUJDES!** Për të shmangur ndonjë rrezik të mundshëm i cili rezulton nga qëndrueshmëria e dobët e pajisjes elektroshtëpiake, sigurohuni që ajo është instaluar sipas udhëzimit.

## **Rrezik nga ngrirja (morthi)**

Mos vendosni asnjëherë ushqim të ngrirë në gojë dhe shmangni prekjen e ushqimeve të ngrira, pasi ato mund të shkaktojnë dëmtim nga ngrica ose morth.

## **Siguria e fëmijëve dhe e personave të dobët**

Kjo pajisje elektroshtëpiake mund të përdoret nga fëmijët e moshës nga 8 vjet e sipër dhe nga personat me aftësi të kufizuara fizike, ndjeshmërie ose mendore apo nga mungesa e eksperiencës dhe njohurive në qoftë se ju ofrohet mbikëqyrje ose udhëzime në lidhje me përdorimin e pajisjes elektroshtëpiake në mënyrë të sigurt dhe të kuptojnë rreziqet e përfshira.

Hiqeni paketimin e synuar për të mbrojtur pajisjen elektroshtëpiake ose pjesët e veçanta të saj gjatë transportit dhe mbajini larg prejës së fëmijëve.

Ai paraqet rrezik plagosje ose asfiksimi.

Mos i lini fëmijët të luajnë me pajisjen elektroshtëpiake.

Mirëmbajtja gjatë përdorimit dhe pastrimi nuk duhet të bëhet nga fëmijët e pa mbikëqyrur.

Kur të hiqni një pajisje të përdorur elektroshtëpiake, shkëputeni kabllin e energjisë, hiqeni derën dhe raftet lerini në pajisjen elektroshtëpiake. Kjo nuk do t'i lejojë fëmijët që të mbyllën në pajisjen elektroshtëpiake.

## **Përkujdesje në lidhje me frogoriferin.**

Pajisja elektroshtëpiake përmban një sasi të vogël gazi R600a, të padëmshëm për mjedisin por të djegshëm. Sigurohuni që nuk do të dëmtohet asnjë pjesë nga sistemi i ftohjes. Një rrjedhje gazi nuk është e dëmshme për mjedisin, por mund të shkaktojë dëmtim të syve ose zjarr.

Në rast të rrjedhjes së gazit, ajroseni dhomën plotësisht, shkëputeni pajisjen elektroshtëpiake nga rrjeti elektrik dhe thërrisni një teknik shërbimi.

# INFORMACION I RËNDËSISHËM PËR PËRDORIMIN E PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE

 **KUJDES!** Hapësirat e ajrosjes në pjesën e mbyllur ose në strukturën e pajisjes elektroshtëpiake, mbajini të papenguara.

Pajisja elektroshtëpiake nuk mund të mund përdoret jashtë dhe nuk duhet të ekspozohet në shi.

Mos mbani lëndë shpërthyese si kanaçe aerosoli me gazra të djegshëm të lëvizshëm në këtë pajisje elektroshtëpiake.

Në qoftë se pajisja elektroshtëpiake nuk do të përdoret për një periudhë të gjatë kohore, fikeni atë duke përdorur butonin përkatës dhe hiqeni nga rrjeti elektrik. Boshatiseni pajisjen elektroshtëpiake, shkrijeni, pastrojini dhe lereni derën të hapur.

Në rast defekti ose mosfurnizimi me energji elektrike, mos e hapni njësinë e ngrirjes për aq kohë sa ngrirësi nuk ka operuar për rreth 16 orë. Pas kësaj periudhe, përdoreni ushqimin e ngrirë ose siguroni ftohje të mjaftueshme (p.sh. një pajisje elektroshtëpiake zëvendësuese).

## **Informacion teknik për pajisjen elektroshtëpiake**

Pllaka e të dhënave mund të gjendet në pjesën e përparme të pajisjes elektroshtëpiake. Ajo tregon të dhënat për tensionin, vëllimin bruto dhe neto, llojin dhe sasinë e gazit ftohës dhe informacionin për klasat klimatike.

Në qoftë se gjuha në pllakën e të dhënave nuk është gjuha e zgjedhjes suaj ose gjuha e vendit tuaj, ndërojeni atë me një nga gjuhët e dhëna.



## MBROJTJA E MJEDISIT

Paketimi është bërë nga materiale miqësore me mjedisin të cilat mund të riciklohen, të hidhen ose të shkatërrohen pa asnjë rrezik për mjedisin.



Heqja e një pajisjeje elektroshtëpiake e cila nuk përdoret më

Për të mbrojtur mjedisin, çojeni pajisjen elektroshtëpiake e cila nuk përdoret më në një qendër grumbullimi të pajisjeve elektroshtëpiake.

Përpara se të veproni kështu, bëni sa më poshtë:

- shkëputeni pajisjen elektroshtëpiake nga rrjeti elektrik;
- mos i lejoni fëmijët të luajnë me pajisjen elektroshtëpiake.



**KUJDES!** Mos e dëmtoni qarkun e gazit ftohës. Kjo gjithashtu mund të ndalojë ndotjen.



**Simboli në produkt ose në paketimin e tij tregon se produkti nuk duhet të trajtohet si një mbetje e zakonshme shtëpiake. Produkti duhet të çohet në një qendër të autorizuar grumbullimi për përpunimin e mbetjeve elektrike dhe elektronike. Hedhja e produktit në mënyrën e duhur mund të ndihmojë në parandalimin e të gjitha ndikimeve negative të cilat mund të ndodhin në mjedis dhe në shëndetin e njerëzve në rast të heqjes jo të rregullt të produktit. Për informacion të detajuar për heqjen dhe përpunimin e produktit, ju lutemi të kontaktoni me organin përkatës bashkiak me detyrën e menaxhimit të mbetjeve, me shërbimin tuaj të hedhjes së mbetjeve ose me dyqanin ku e keni blerë produktin.**



# KËSHILLA PËR KURSIMITIN E ENERGJISË ME PAJISJET ELEKTROSHTËPIAKE FTOHËSE

---


- Instaloheni pajisjen elektroshtëpiake siç specifikohet në manualin e udhëzimit.
- Mos e hapni derën më shpesh nga sa është e nevojshme.
- Herë pas here, sigurojuni që ajri poshtë pajisjes elektroshtëpiake qarkullon pa pengesë.
- Njësia e kondensatorit në murin e pasëm duhet të mbahet e pastër (shikoni kapitullin “Pastrimi i pajisjes elektroshtëpiake”).
- Në qoftë se guarnicioni është i dëmtuar ose nuk bën një mbyllje të përsosur për çfarëdo arsye, zëvendësojeni sa më shpejt që të jetë e mundur.
- Mbajeni ushqimin në enë të mbyllura mirë ose në paketiminin e duhur.
- Përpara se të vendosni ushqimin në frigorifer, lëreni të ftohet në temperaturën e dhomës.
- Shkrijeni ushqimin e ngrirë në ndarjen e frigoriferit.
- Për të përdorur të gjithë vëllimin e ndarjes së brendshme të ngrirësit, hiqni disa nga sirtarët sipas përshkrimit në manualin e udhëzimit.
- Shkrijeni ngrirësin tuaj tradicional kur në sipërfaqet e frigoriferit të jetë krijuar një shtresë ngrice ose akulli prej 3-5 milimetrash.
- Sigurohuni që vendosja e rafteve në ndarje të jetë në uniformë dhe që ushqimi të vendoset në mënyrë që ajri të qarkullojë lirisht në pjesën e brendshme të pajisjes elektroshtëpiake (zbatoni vendosjen e rekomanduar të ushqimit sipas përshkrimit në udhëzime).
- Në pajisjet elektroshtëpiake me ventilator, mos i bllokoni të çarat ose vrimat e ventilimit.
- Në qoftë se nuk keni nevojë për ventilatorin ose për jonizuesin, fikini ato duke kaluar në konsumin e zvogëluar të energjisë.

# INSTALIMI DHE LIDHJA

## ZGJEDHJA E DHOMËS

- Pajisjen elektroshtëpiake instaloheni në një dhomë të thatë dhe të ajrosur mirë. Pajisja elektroshtëpiake do të opreojë siç duhet në qoftë se temperatura e mjedisit është në intervalin e specifikuar në tabelë. Klasi e pajisjes elektroshtëpiake është dhënë në tabelën e të dhënave/etiketën me informacionin bazë për pajisjen elektroshtëpiake.

Klasi	Temperatura	Lagështira Relative
SN (nënnormal)	nga +10 °C deri në +32 °C	≤75%
N (normal)	nga +16 °C deri në +32 °C	
ST (nëntropikal)	nga +16 °C deri në +38 °C	
T (tropikal)	nga +16 °C deri në +43 °C	


-  Mos e vendosni një pajisje elektroshtëpiake në një dhomë ku temperatura mund të bjerë më poshtë se 5 °C, pasi kjo gjë mund të shkaktojë një operim jonormal ose mosfunksionim të pajisjes elektroshtëpiake!
- Pas instalimit, priza e lidhjes me rrjetin e pajisjes elektroshtëpiake duhet të jetë e prekshme!
- Mos e vendosni pajisjen elektroshtëpiake në afërsi të pajisjeve elektroshtëpiake të cilat rrezatojnë nxehtësi, si sobat e gatimit, sobat e ngrohjes, radiatorët, nxehësat e ujit, etj. Dhe mos e ekspozoni ndaj rrezeve direkte të diellit. Pajisja elektroshtëpiake duhet të qëndrojë të paktën 3 cm larg nga soba e gatimit me gaz ose elektrike ose të paktën 30 cm larg nga soba ngrohëse me naftë ose me lëndë djegëse të ngurta. Në qoftë se distanca midis këtyre burimeve të nxehtësisë dhe pajisjes elektroshtëpiake është më e vogël, përdorni një panel izolues.

**Shënim:** Vendoseni pajisjen elektroshtëpiake në një dhomë mjaftueshëm të madhe. Duhet të jetë të paktën një hapësirë prej 1 m<sup>3</sup> për 8 gram gazi ftohës. Sasia e gazit ftohës tregohet në pllakën e të dhënave në pjesën e brendshme të pajisjes elektroshtëpiake.

- Në bazën e njësisë së kuzhinës, të synuar për të vendosur pajisjen elektroshtëpiake të integruar, duhet të jetë të paktën një hapësirë e lirë prej 200 cm<sup>2</sup>, për qarkullim të përshtatshëm të ajrit. Në pjesën e sipërme të pajisjes elektroshtëpiake, ajri del jashtë, prandaj përpiquini të mos e mbuloni hapësirën për nxjerrjen e ajrit. Mosmarrja parasysh e këtij paralajmërimi mund të shkaktojë dëmtim të pajisjes elektroshtëpiake.


## Distancatori i pasëm

Vidhoseni distancatorin e pasëm në pjesën e pasme të pajisjes.



## Kriteret e Hapësirës


- Mbajeni hapësirë të mjaftueshme për të hapur derën.
- Mbani të paktën 50 mm boshllëk në dyja anët.




## Niveli i pajisjes

Për ta bërë këtë, rregulloni dy këmbët e nivelimit në pjesën e përparme të pajisjes.

Në qoftë se pajisja nuk është e niveluar, dyert dhe izoluesit magnetikë gjatësorë nuk do të puthiten siç duhet.




## LIDHJA E PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE



- Lidhni pajisjen elektroshtëpiake me rrjetin elektrik duke përdorur një kabëll. Priza në mur duhet të jetë e pajisur me tokëzim (fole sigurie). Tensioni dhe frekuenca nominale janë treguar në tabelën e të dhënave/etiketën me informacionin bazë për pajisjen elektroshtëpiake.
- Pajisja elektroshtëpiake duhet të lidhet me rrjetin elektrik dhe të tokëzohet në përputhje me standardet dhe rregulloret në fuqi. Pajisja elektroshtëpiake do t'li rezistojë shmangieve afatshkurtëra nga tensioni nominal por jo më shumë se +/- 6%.

# PËRSHKRIMI I PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE


Pjesa e brendshme e pajisjes elektroshtëpiake mund të ndryshojë sipas modelit të pajisjes elektroshtëpiake.



- 1 Termostati dhe drita
- 2 Raftet e xhamit
- 3 Kapaku i ndarjes së freskët
- 4 Ndarja e freskët
- 5 Ballkonet
- 6 Sirtarët e ngrirjes
- 7 Këmbët niveluese

# KOMANDIMI I APARATIT

---



- Futeni pajisjen tuaj elektroshtëpiake në prizë. Temperatura e brendshme kontrollohet nga një termostat. Ajo ka 8 nivele të vendosjes. 1 është niveli më i ngrohtë, 7 janë nivele më të ftohtë dhe 0 është e fikur.
- Pajisja elektroshtëpiake nuk mund të funksionojë në temperaturën e duhur në qoftë se është veçanërisht nxehtë ose në qoftë se e hapni derën shpesh.


# NDRYSHIMI I DREJTIMIT TË HAPJES SË DERËS

---


Veprat e nevojshme: Kaçavidë Philips (kryq), Kaçavidë e sheshtë, Çelës hekgagon.

- Sigurohuni që pajisja të jetë e hequr nga priza dhe bosh.
  - Për të hequr derën, është e nevojshme ta anosni pajisjen nga mbrapa. Duhet ta mbështesni pajisjen në diçka të qëndrueshme, në mënyrë që ajo të mos përmbysset gjatë procesit të kthimit të derës.
  - Të gjitha pjesët e hequra duhet të ruhen për të bërë rivendosjen e derës.
  - Mos e shtrini pajisjen rrafsh në tokë, pasi kjo mund të dëmtojë sistemin e ftohësit.
  - Është më mirë që gjatë montimit me pajisjen të merren 2 persona.
1. Hiqini katër vidhat në kapakun e sipërm dhe pastaj hiqeni atë.
  2. Zhvidhoseni menteshën e sipërme, pastaj hiqeni derën e sipërme dhe vendoseni në një vend të butë për të shmangur gërvishtjet.
  3. Hiqeni kunjin me një kaçavidë dhe kthejeni mbajtësen e menteshës. Pastaj rivendoseni kunjin te mbajtësja e menteshës.
  4. Zhvidhoseni menteshën e mesit. Pastaj ngrijeni derën e poshtme dhe vendoseni në një vend të butë për të shmangur gërvishtjet.
  5. Zhvendosini kapakët e vrimës së menteshës nga ana e majtë në anën e djathtë.
  6. Zhvidhoseni menteshën e poshtme. Pastaj hiqni këmbët e rregullueshme nga të dy anët.
  7. Zhvidhoseni dhe hiqeni kunjin e menteshës së poshtme, kthejeni mbajtësen dhe zëvendësojeni atë.
  8. Rivendoseni mbajtësen që përshtatet me kunjin e menteshës së poshtme. Rivendosini të dyja këmbët e rregullueshme. Spostojeni derën e poshtme në pozicionin e duhur.
  9. Kthejeni menteshën e mesit në anën e kundërt të drejtimit 180°, pastaj spostojeni në pozicionin e duhur majtas. Vendoseni kunjin e menteshës së mesit në vrimën e sipërme të derës së poshtme, pastaj shtrëngojuini vidhat.
  10. Vendoseni përsëri derën e sipërme. Sigurohuni që dera të jetë e inkuadruar horizontalisht dhe vertikalisht, në mënyrë që izoluesit të jenë të puthitur në të gjitha anët, përpara se të shtrëngoni përfundimisht menteshën e sipërme. Pastaj fiksojeni menteshën dhe vidhoseni në pjesën e sipërme të pajisjes.
  11. Vendoseni kapakun e sipërm dhe pastaj vidhoseni përsëri.


1




2




3




4




5




6




7




8




9



10




11




# PAJISJET E BRENDSHME TË PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE

## RAFTET E LËVIZSHME



Muret e frigoriferit janë të pajisura me një seri udhëzuesish në mënyrë që raftet të mund të vendosen sipas dëshirës.

## BALLKONET E DERËS



Për të lejuar ruajtjen e pakove ushqimore të madhësive të ndryshme, ballkonet e derës mund të vendosen në lartësi të ndryshme. Për të bërë këto rregullime të procedohet si më poshtë: gradualisht tërhiqeni ballkonin në drejtim të shigjetave derisa të lirohet, pastaj rivendoseni sipas nevojës.



# SHPËRNDARJA E REKOMANDUAR E USHQIMIT NË PAJISJEN ELEKTROSHTËPIAKE

## Seksionet në ndarjen frigoriferike:

- **pjesa e sipërme:** ushqime në kanaçe, bukë, verë, brumëra etj.
- **pjesa e mesme:** produkte të përditshme, ushqime të gatshme, ëmbëlsira, pije të buta, birra, ushqime të gatuar, etj.
- **Ena e frutave dhe perimeve:** fruta të freskëta, perime, sallatra, rrënjë perimesh, patate, qepë, hudhra, domate, lakër turshi, rrepa etj.



## Seksionet në ndarjen e derës frigoriferike:

- **Enët në derën e sipërme/të mesme:** vezë, gjalpë, djathë, etj.
- **Enët në derën e poshtme:** pije freskuese, kanaçe, shishe

**i** **Mos mbani fruta** (banane, ananas, papaja, limona) dhe perime (kungulleshka, patllixhana, kastraveca, specia, domate dhe patate) të ndjeshme ndaj temperaturave në frigorifer.

## Seksionet ngrirëse:

- në ngrirje, mbahen ushqime të ngrira (shikoni kapitullin Ngrirja dhe mbajtja e ushqimeve të ngrira).

**i** **Mos mbani në ngrirje sa më poshtë:** sallatë marule, vezë, mollë, dardha, rrush, pjeshkë, kos, qumësht i kondensuar, salcë kosi dhe majonezë.

# MBAJTJA E USHQIMIT NË FRIGORIFER

---

## KËSHILLA TË RËNDËSISHME NË LIDHJE ME MBAJTJEN E USHQIMEVE



Përdorimi, i rregullt i pajisjes elektroshtëpiake, paketimi në mënyrën e duhur, mbajtja e temperaturës së duhur dhe zbatimi i standardeve të higjienës së ushqimit, kanë një ndikim vendimtar në cilësinë e mbajtjes së ushqimit.

Vini re datat e skadencës së ushqimit, të treguara në paketim.

Ushqimet e ruajtura në frigorifer duhet të mbahen në enë të mbyllura ose në paketimin e duhur për të mos e lejuar lëshimin ose marrjen e aromave dhe të lagështirës.

Mos mbani në frigorifer lëndë të djegshme, të paqëndrueshme dhe shpërthyes.

Shishet me përmbajtje të lartë alkooli duhet të mbyllen mirë dhe të mbahen në pozicion të ngritur.

Disa solucione organike, vajra esenciale të lëkurës së limonit dhe portokallit, acid gjalpi, etj., mund të dëmtojnë sipërfaqet plastike në rast të kontaktit të zgjatur, duke shkaktuar dëmtim dhe vjetërim të parakohshëm të këtyre materialeve.

Aromat e padëshiruara paralajmërojnë mungesën e pastërtisë së pajisjes elektroshtëpiake ose përmbajtje të prishura (shiko kapitullin Pastrimi i Pajisjes Elektroshtëpiake).

Në qoftë se ikni nga shtëpia për një periudhë të gjatë kohore, hiqini sendet që mund të prishen nga frigoriferi.

## MBAJTJA E USHQIMEVE

LLOJI I USHQIMIT	Temperatura Optimale e ruajtjes (°C)	Niveli Optimal i ruajtjes së lagështirës (%)	Koha e pëafërt e ruajtjes
Mish derri	-1 deri në 4	95	3 ditë
Mish viçi	0 deri në 4	95	deri në 3 javë
Mish qingji	0 deri në 4	95	14 ditë
Mish Pule	0 deri në 4	95	3 ditë
Peshku	0 deri në 4	95	3 deri në 10 ditë
Molusqet	0 deri në 4	95	2 ditë
Mish viçi i njomë	1,5	95	16 javë
Produkte të përditshme (kos, salcë kosi, gjalpë, djathë i butë, feta djathi etj.)	2 deri në 4	95	7 deri në 10 ditë
Panxhar	0	95	3 deri në 5 muaj
Brokoli	0	95-100	10 deri në 14 ditë
Lakër, e re	0	98-100	3 deri në 6 javë
Karrota, të qëruara	0	98-100	4 deri në 5 muaj
Marule, në dimër	0	95-100	2 deri në 3 javë
Hudhër	0	65-70	6 deri në 7 muaj
Lakër Kohlrabi	0	98-100	2 deri në 3 muaj
Lakër Brukseli	0	90-95	3 deri në 5 javë
Lakër kineze	0	95-100	2 deri në 3 muaj
Lakër, varietete të vona	0	98-100	3 deri në 4 muaj
Karrota	0	95-100	2 javë
Lule lakër	0	95-98	2 deri në 4 javë
Selino, normale	0	98-100	2 deri në 3 muaj
Perime me gjethe jeshile	0	95-100	10 deri në 14 ditë
Lakër e kuqe	0	95-100	2 deri në 4 javë
Misër, i ëmbël	0	95-98	5 deri në 8 ditë

<b>LLOJI I USHQIMIT</b>	<b>Temperatura Optimale e ruajtjes (°C)</b>	<b>Niveli Optimal i ruajtjes së lagështirës (%)</b>	<b>Koha e pëafërt e ruajtjes</b>
Presh	0	95-100	2 deri në 3 muaj
Kërpudha	0	95	3 deri në 4 ditë
Majdanoz	0	95-100	2 deri në 3 ditë
Pastinak	0	98-100	4 deri në 6 muaj
Repa, në dimër	0	95-100	2 deri në 4 muaj
Rrepa	0	98-100	10 deri në 12 muaj
Lule lakër	0 deri në 2	90-95	2 deri në 4 javë
Qepë	0 deri në 2	65-70	6 deri në 7 muaj
Sparangje	0 deri në 2	95-100	2 deri në 3 javë
Bizele, jeshile	0 deri në 2	95-98	1 deri në 2 javë
Perime të copëtuara	0 deri në 2	90-95	deri në 5 ditë
Lakër Brukseli	0 deri në 2	90-95	1 deri në 2 javë
Kulumbri	0 deri në 2	90-95	3 deri në 4 javë
Kastraveca	4 deri në 10	95	10 deri në 14 ditë
Patate	7 deri në 10	90-95	deri në 9 muaj
Avogado, i paqëruar	7 deri në 10	85-95	deri në 6 javë
Specë	7 deri në 10	90-95	2 deri në 3 javë
Domate	10 deri në 12	85-90	4 deri në 7 ditë
Bizele, fara	< 15	40-50	6 deri në 10 muaj
Dardha	-3	90-95	2 deri në 7 muaj
Kajsi	-1	90-95	1 deri në 3 javë
Luleshtrydhe	0	90-95	3 deri në 7 ditë
Mjedra	0 deri në 2	90-95	2 deri në 3 ditë
Stafidhe	0 deri në 2	90-95	1 deri në 4 javë
Manaferra	0 deri në 2	90-95	14 ditë
Qersh	0 deri në 2	90-95	2 deri në 3 javë
Rrush	0 deri në 2	85	2 deri në 8 javë
Kivi, të qëruara	0 deri në 2	90-95	1 deri në 3 muaj
Pjeshkë	0 deri në 2	90-95	2 deri në 4 javë

<b>LLOJI I USHQIMIT</b>	<b>Temperatura Optimale e ruajtjes (°C)</b>	<b>Niveli Optimal i ruajtjes së lagështirës (%)</b>	<b>Koha e pëafërt e ruajtjes</b>
Qersh	0 deri në 2	90-95	2 deri në 3 javë
Kivi, të paqëruara	0 deri në 2	90-95	2 deri në 6 muaj
Nektarina	0 deri në 2	90-95	1 deri në 3 javë
Portokalle	0 deri në 2	90-95	2 deri në 4 javë
Hurma	0 deri në 2	90-95	2 deri në 3 muaj
Kumbulla	0 deri në 2	90-95	2 deri në 5 javë
Fruta, të copëtuara	0 deri në 2	90-95	deri në 10 ditë
Mollë	0 deri në 4	90-95	1 deri në 12 muaj
Pjepër	4	90-95	15 ditë
Portokalle	4 deri në 7	90-95	2 deri në 4 javë
Mandarina	5 deri në 8	90-95	2 deri në 4 javë
Mango	10 deri në 13	85-95	2 deri në 3 javë
Pjepër	10 deri në 13	85-95	1 deri në 2 javë
Ananas	10 deri në 13	85-95	2 deri në 4 javë
Limona	11 deri në 13	90-95	2 deri në 3 javë
Shalqi	12 deri në 15	85-95	1 deri në 3 javë
Banane, të qëruara	13 deri në 16	85-95	3 ditë
Qitro	13 deri në 16	90-95	1 deri në 3 javë

# NGRIRJA DHE MBAJTJA E USHQIMEVE TË NGRIRA

---

## KËSHILLA TË RËNDËSISHME PËR NGRIRJEN



Përdoreni ngrirësin vetëm për të ngrirë ushqimet e përshtatshme për ngrirje. Përdorni gjithmonë ushqime cilësore dhe të freskëta.

Zgjidhni paketimin më të përshtatshëm për ushqimin dhe përdoreni paketimin në mënyrë të rregullt.

Sigurohuni që paketimi është i mbyllur mirë ndaj ajrit dhe ujit, në mënyrë që ushqimi të mos thahet dhe të mos i humbë vitaminat e tij.

Shënojeni llojin e ushqimit, sasinë dhe datën e ngrirjes në paketim.

Është e rëndësishme që ushqimi të ngrijë shpejt. Rrjedhimisht, rekomandohen paketimet më të vogla. Përpara se ta vendosni në ngrirje, ushqimin vendoseni në pjesën frigoriferike.

## MBAJTJA E USHQIMEVE TË NGRIRA NË MËNYRË INDUSTRIALE

- Kur mbahen dhe përdoren ushqime të ngrira, zbatoni udhëzimet e prodhuesit. Temperatura dhe data e skadencës janë të shkruara në paketim.
- Zgjidhni vetëm ushqim me paketim të padëmtuar, të mbajtur në ngrirësa në temperaturat prej -18 °C ose më të ulëta.
- Mos blini ushqim të mbuluar me brymë (akull) pasi kso gjë tregon se ai është shkrirë pjesërisht disa herë dhe se është i një cilësie më të ulët.
- Mbrojeni ushqimin nga shkrirja gjatë transportit. Në rast të rritjes së temperaturës, koha e mbajtjes duhet të jetë më e shkurtër dhe do të ulet cilësia.

# KOHA E MBAJTJES SË USHQIMEVE TË NGRIRA

## KOHA E REKOMANDUAR E MBAJTJES NË NGRIRËS

Lloji i ushqimit	Koha
Fruta, mish lope	nga 10 deri në 12 muaj
Perime, mish viçi, shpendë	nga 8 deri në 10 muaj
Mish dreri	nga 6 deri në 8 muaj
Mish derri	nga 4 deri në 6 muaj
Mish i grirë ose në copa të vogla	4 muaj
Bukë, brumëra, ushqime të gatuar, copa peshku lean fish	3 muaj
Të brendshme	2 muaj
Sallamra të tymosur, peshq të dhjamur	1 muaj

## SHKRIRJA E USHQIMEVE TË NGRIRA

Ngjirja e ushqimit nuk i vret mikroorganizmat. Pasi të jetë shkrirë ushqimi, bakteret riaktivizohen dhe ushqimi priset me lehtësi. Përdoreni ushqimin e shkrirë pjesërisht ose plotësisht sa më shpejt që të jetë e mundur.

Shkrirja e pjesshme ul vlerën ushqyese të ushqimit, frutave të veçanta, perimeve dhe ushqimeve të gatshme.

# SHKRIRJA E PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE

---

## SHKRIRJA AUTOMATIKE E FRIGORIFERIT

Frigoriferi nuk ka nevojë të shkrihet, sepse akulli në pjesën e brendshme të murit të pasëm shkrin automatikisht.

I gjithë akulli i grumbulluar do të shkrijë kur njësia e kompresorit të mos jetë aktive. Pikat do të rrjedhin nëpërmjet një hapësire në murin e pasëm të frigoriferit në tabakanë e vendosur poshtë kompresorit, nga ku do të avullojnë.

Sigurohuni që hapësira në murin e pasëm të pjesës së brendshme të frigoriferit nuk do të bllokohet asnjëherë nga ushqimi ose nga asnjë objekt tjetër.

Në qoftë se në murin e pasëm të pjesës së brendshme të frigoriferit formohet një shtresë e trashë akulli (3-5 mm), fikeni pajisjen elektroshtëpiake dhe shkrijeni manualisht pajisjen elektroshtëpiake.

## SHKRIRJA E NJË NGRIRËSI TRADICIONAL

- Shkrijeni ngrirësin kur të krijohet një shtresë prej afërsisht 3-5 millimetra akull ose brymë.

Pas kësaj periudhe, hiqini ushqimet nga ngrirja dhe mbrojjini ato nga shkrirja.

- Fikeni pajisjen elektroshtëpiake (shikoni kapitullin Ndezja/Fikja e pajisjes elektroshtëpiake) dhe hiqeni kabllin e furnizimit me energji.
- Mos përdorni thikë ose ndonjë objekt tjetër të mprehtë për të hequr ngricën, pasi mund të dëmtoni sistemin e ftohjes.
- Mos përdorni thikë ose ndonjë objekt tjetër të mprehtë për të hequr ngricën, pasi mund të dëmtoni ndonjë tub të sistemit të ftohjes.
- Për të përshpejtuar procesin e shkrirjes, vendosni një tas me ujë të nxehtë në raftin prej xhami.
- Clean and dry the appliance interior (see chapter Cleaning the Appliance).



# PASTRIMI I PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE



**Përpara pastrimit, hiqeni pajisjen elektroshtëpiake nga rrjeti i furnizimit me energji** – fikeni pajisjen elektroshtëpiake (shikoni kapitullin Ndezja dhe Fikja e Pajisjes Elektroshtëpiake) dhe hiqeni kabllin e energjisë nga priza e murit.

- Përdorni një leckë të butë për t'i pastrua të gjitha sipërfaqet. Pastruesit të cilët përmbajnë substanca gërryese, acide ose tretës nuk janë të përshtatshëm për pastrim, pasi ata mund të dëmtojnë sipërfaqen.

Pastrojeni **pjesën e jashtme** të pajisjes elektroshtëpiake me ujë ose me një tretësirë uji me sapun.


Sipërfaqet e lyera me llak dhe prej alumini mund të pastrohen me ujë të vakët në të cilin keni shtuar detergjent të lehtë. Përdorimi i pastruesave me përmbajtje të ulët alkooli lejohet (p.sh. pastruesit e dritareve). Për pastrimin e materialeve plastike mos përdorni pastrues të cilët përmbajnë alkool.



**Pjesa e brendshme** e pajisjes elektroshtëpiake mund të pastrohet me ujë të vakët në të cilin keni hedhur pak uthull.



- Mos i lani pjesët e aksesorëve të brendshëm të pajisjes elektroshtëpiake në lavastovilje, pasi mund të dëmtohen.



- Për të shmangur rrjedhjen në frigorifer të ujit që shkrihet, pastrojeni periodikisht vrimën e shkarkimit në pjesën e pasme të ndarjes së frigoriferit. Për pastrimin e vrimës, përdorni një pastrues siç tregohet në foto.
- Pas pastrimit, ndizeni përsëri pajisjen elektroshtëpiake dhe vendoseni ushqimin.

# ZGJIDHJA E PROBLEMEVE

Problemi:	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
Pajisja elektroshtëpiake nuk funksionon	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Çelësi i rregullimit të temperaturës është vendosur në numrin "0".</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vendoseni çelësin në një numër tjetër për të ndezur pajisjen elektroshtëpiake.</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Spina elektrike nuk është e vendosur ose është e lirshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Futeni spinën elektrike.</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Siguresa është djegur ose është me defekt</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolloni siguresën, zëvendësojeni nëse është e nevojshme.</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Priza është me defekt</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Defektet e rrymës elektrike duhet të rregullohet nga një elektrikist.</li> </ul>
Ushqimi është shumë i ngrohtë.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Temperatura nuk është rregulluar siç duhet.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ju lutemi shikoni seksionin e Vendosijes së Temperaturës në fillim.</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dera ka qenë e hapur për një periudhë të gjatë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hapeni derën vetëm për aq kohë sa është e nevojshme.</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Në pajisjen elektroshtëpiake është vendosur një sasi e madhe ushqimi të ngrohtë brenda 24 orëve të fundit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kthejeni përkohësisht rregullimin e temperaturës në një nivel më të ftohtë.</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pajisja elektroshtëpiake është afër një burimi të nxehtësisë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ju lutemi shikoni në seksionin e vendit të instalimit.</li> </ul>
Pajisja elektroshtëpiake ftoh shumë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Temperatura është vendosur shumë e ftohtë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kthejeni përkohësisht çelësin e rregullimit të temperaturës në një nivel më të ngrohtë.</li> </ul>

<b>Problemi:</b>	<b>Shkaku i mundshëm</b>	<b>Zgjidhja</b>
Zhurma të pazakonshme	• Pajisja elektroshtëpiake nuk është në nivel.	• Rregullojini këmbët.
	• Pajisja elektroshtëpiake takon muret ose objekte të tjera.	• Zhvendosni pak pajisjen.
	• Një komponent, p.sh. një tub, në pjesën e pasme të pajisjes elektroshtëpiake ka takuar një pjesë tjetër të pajisjes ose murin.	• Në qoftë se është e nevojshme, hiqeni që aty me kujdes komponentin.
Ka ujë në dysHEME	• Është e bllokuar vrima e shkarkimit të ujit.	• Shikoni seksionin e Pastrimit.
Paneli anësor është i nxehtë	• Brenda panelit është kondensatori.	• Është normale.

Nëse defekti shfaqet përsëri, kontaktoni Qendrën e Shërbimit.

# INFORMACION NË LIDHJE ME ZHURMËN E PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE

---

Ftohja në ngrirësat frigoriferikë bëhet e mundur nga një sistem ftohës i cili përfshin edhe një kompresor (në disa pajisje elektroshtëpiake edhe një ventilator), i cili krijon pak zhurmë. Niveli i zhurmës është në varësi të instalimit, përdorimit të duhur dhe moshës së pajisjes elektroshtëpiake.

- Pas lidhjes së pajisjes elektroshtëpiake me rrjetin elektrik, operimi i kompresorit ose zhurma e lëngut që rrjedh, mund të jetë disi më e lartë. Kjo nuk është një shenjë e keqfunksionimit dhe nuk do të ndikojë në jetën e dobishme të pajisjes elektroshtëpiake. Me kalimin e kohës, operimi i pajisjes elektroshtëpiake dhe zhurma do të bëhen më të qeta.
- Ndonjëherë, zhurma ta pazakonta ose më të forta mund të dëgjohen gjatë operimit të pajisjes elektroshtëpiake; këto janë kryesisht si rezultat i instalimit jo të duhur:
  - Pajisja elektroshtëpiake duhet të jetë në nivel dhe e palëvizshme në një bazë të fortë.
  - Pajisja elektroshtëpiake nuk duhet të jetë në kontakt me murin ose më ndonjë mobilje të afërt.
  - Sigurohuni që pajisjet e brendshme të jenë të futura siç duhet në vendet e tyre dhe që zhurma nuk shkaktohet nga kanaçet që kërcasin, nga shishet apo nga enët e tjera të vendosura ngjitur me njëra-tjetrën.
- Për shkak të ngarkesës së lartë të punës në sistemin e ftohjes kur dera hapet më shpesh ose për një kohë më të gjatë, kur futet një sasi e madhe ushqimi të freskët ose kur janë të aktivizuar funksionet e ngrirjes ose të ftohjes intensive, pajisja elektroshtëpiake mund të bëjë përkohësisht më shumë zhurmë.

NE REZERVOJMË TË DREJTËN PËR NDRYSHIME TË CILAT NUK E CËNOJNË  
FUNKSIONALITETIN E PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE.

Gorenje, d.d.  
Partizanska 12  
SI - 3320 Velenje, Slovenija  
info@gorenje.com  
www.gorenje.com